

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me zyratën ligjore, Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale ndaj të akuzuarit E. R nga fsh. Zh, K. e Gj, të cilin sipas autorizimit e mbron av.S. M, për dy vepra penale, Sulmi, nga neni 187, par.1 dhe Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188, paragrafi 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr. 1531/2016, të datës 23.08.2016, e sipas Marrëveshjes për pranimin e fajsisë, të datës 06.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, më datën 15.06.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa, më datë 19.06.2017, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari E. R, nga babai M dhe nëna H, e lindur B, i lindur më datë në fshatin Ll, Komuna e Gjilanit, jeton në fsh. Zh, K. e Gj, i martuar, baba i tre fëmijëve, bujk, ka të kryer shkollën filllore, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**I.** Sepse, më datë 16.08.2016, rreth orës 10:00 min, në fsh. Zh, K. e Gj, në shtëpinë e tyre, për shkak të dyshimit se e njëjta e kishte lajmëruar policinë për problemet që i kishte me te, me dashje, pa pëlqimin e saj ka përdorë forcën ndaj nënës së vet-tani të dëmtuarës H.R, në atë mënyrë që me duar për nofullë , e më pas edhe për fyti e ka shtrënguar dhe me duar e ka goditur edhe nëpër fytyrë me shuplaka, mirëpo, për fat, nuk i ka shkaktuar ndonjë lëndim trupor të asaj natyre, për të cilat do të kishte nevojë për ndihmë mjeksore,

-me çka ka kryer veprën penale **Sulmi**, nga **neni 187, par.1**, të KPRK-ës,

**II.** në të njëjtën ditë dhe vend, rreth orës 13.00 min., për shkak të një fjalosjeje me vëllain e vet, tani të dëmtuarin F. R rreth trajtimit të nënës së tyre, së bashku me baxhanakun e tij, B. F nga fsh. Zh, e ka sulmuar të njëjtin me grushte dhe shqelma në kokë dhe pjesë tjera të trupit, me ç'rast, i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të pjesëve të kokës, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-me çka, në bashkëveprim ka kryer veprën penale, **Lëndimi i lehtë trupor**, nga **neni 188 par.1**, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj, bazuar dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

**E G J Y K O N  
M E D Ë N I M M E G J O B Ë**

Për veprën penale nën **dispozitivin nën I**, me Dënim Gjore në shumën prej **700 (shtatëqind €**,

Për veprën penale nën **dispozitivin nën II**, me Dënim Gjore, në shumën prej **500 (pesëqind €**,

Në bazë të **nenit 80** të KPRK-së , të akuzuarit i shqiptohet një **Dënim Unik**, në shumën prej **1000 (një mijë) €**, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, dënimi i përmendur do t'i shndërrohet në dënim burgu, duke llogaritur për çdo 15 €, një ditë burgu.

Në dënimin e përmendur të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim , në kohëzgjatje prej 16.08.2016 deri më dt. 09.09.2016, që dmth. 25 (njëzet e pesë ) ditë

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **30 (tridhjetë) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit udhëzohen që kërkesën e tij pasurore-juridike të i realizojnë në kontest civil-juridik në gjykatën kompetente

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr.1531/2016, të datës 23.08.2016, kundër të akuzuarit E. R, për dy vepra penale, Sulmi, nga neni 187, paragrafi 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, përmes prokurores së shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin Latif Syla dhe mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare av.B. D.

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 02.05.2017, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësen e tij dhe prokurorja në fjalë, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr.338/2017 të datës 01.03.2017.

Mbrojtësja e të pandehurit, av. B.D, deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjithashtu kërkoi nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje, dhe t'i lejojë të mbrojturit të saj pagesën e dënimit në këste.

I pandehuri L.S, deklaroi se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtëses së tij, pasi që marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësen e tij, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkoi nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje. Gjithashtu në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtëses së tij, e as prokurores së shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me të do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK -së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 207/2017, më datë 03.05.2017**

**Praktikantja**  
Albana Islami

**Gjykatësja e vetme gjykuese**  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.